



RAPORT

PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Titulli: “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit ”

Subjekti: “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Përgatitur: 15 Prill 2019

Auditimi është kryer mbështetur në planin vjetor të Auditimeve të KLSH-së për vitin 2019 të Miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me vendim nr. 256 datë 31.12.2018 si dhe programit të auditimit të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.” nr. 1435/1, datë 11/02/2019.

Periudha e Auditimit: 01.01.2018 – 31.12.2018

Afati i auditimit: 07.01.2019 – 18.08.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

PËRMBAJTJA

| Nr. | EMËRTIMI | Faqe |
|--------------|---|------|
| I. | Përmbledhje | 3 |
| II. | Çfarë kemi audituar | 3 |
| III. | Pse është i rëndësishëm ky auditim | 4 |
| IV. | Gjetjet kryesore | 4 |
| V | Hyrje | 7 |
| VI | Rezultatet e auditimit | 8 |
| VI.1 | Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK | 8 |
| | <i>a.</i> Verifikim i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK | 9 |
| | <i>b.</i> Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve me impakt në ofrimin e shërbimit | 13 |
| VI.2 | Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjisë e informacionit | 14 |
| | <i>b.</i> Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement) | 14 |
| VI.3 | Auditimi i Sigurisë së Informacionit | 17 |
| | <i>a.</i> Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit | 17 |
| | <i>b.</i> Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre | 19 |
| VI.4 | Auditimi i sistemeve të matjes dhe faturimit | 22 |
| | <i>a.</i> Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output | 22 |
| VI.4 | Të ndryshme të dala gjatë auditimit | 31 |
| VII. | Disa Konstatime dhe Rekomandime | 39 |
| VIII. | Tabela e shkurtimeve. | 51 |



I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014, nga data 07.01.2019 deri më datë 18.03.2019 zhvilloi një Auditim të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Në opinionet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë auditimit janë mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, si më poshtë:

- Mandati për kryerjen e Auditimit mbështetet në ISSAI 1 Neni 22 dhe Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Nenet 3 dhe 14
- Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA)¹, Manuali Aktiv i TI.
- COBIT 4.1 Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit.²
- Udhëzime mbi Auditimet Teknologjinë e Informacionit, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23.³
- ISSAI 100.36,48 Udhëzime për të gjitha auditimet e sektorit publik⁴.
- ISSAI 5310 - udhëzues për shqyrtimin e sigurisë së sistemit të informacionit (ISS) në organizatat qeveritare.

II. ÇFARË KEMI AUDITUAR

Fushat e auditimit

Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Verifikim i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK
Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve me impakt në ofrimin e shërbimit

Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjisë e informacionit

Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement)

Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit
Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre

Auditimi i sistemeve të matjes dhe faturimit

Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output

Të ndryshme të dala gjatë auditimit

¹ <http://www.intosaiitaudit.org/WGITA23rd/23rdWGITAMeeting/Arabic%20IT%20Audit%20Handbook.pdf>:
http://www.klsh.org.al/web/Manual_i_Auditimit_te_Teknologjise_se_Informacionit_1488_1.php

² http://www.klsh.org.al/web/COBIT_4_1_Objektivat_e_Kontrollit_te_Teknologjise_se_Informacionit_1555_1.php

³ <http://www.issai.org/data/files/75/61/65/99/F5DF8510F72E9F859B59F9C2/issai-5300-e-exposure-draft.pdf>

⁴ http://www.klsh.org.al/web/Standardet_Nderkombetare_te_Auditimit_ISSAI_1_400_1867_1.php



III. PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM KY AUDITIM

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka rëndësi për të verifikuar sesi UKL përdor teknologjinë e Informacionit për ofrimin një shërbimi të qëndrueshëm në grumbullimin, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm si dhe ujërave të ndotura, për të gjithë konsumatorët në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit dhe nëse sistemet e teknologjisë e përdorura përmbushin nevojat, pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë.

IV. GJETJET KRYESORE

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:

1.1 Titulli i gjetjes Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka regjistër rishikim për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

1.2 Titulli i gjetjes Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-ëve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

1.3 Titulli i gjetjes Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme. **Situata:** Mos menaxhim i incidenteve, mos identifikim dhe vlerësim i risqeve IT, mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A në bashkëpunim me specialistin e IT të marrin masa për:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

- a. Monitorimin e risqeve në infrastrukturën IT nëpërmjet identifikimit, prioritarizimit hartimit të një plan veprimi për minimizimin e tyre.
- b. dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve në infrastrukturën IT.
- c. menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

2. Titulli i gjetjes UKL SH.A përdor Sistemin e Faturimit “X”

- a. Të pa regjistruar si aset
- b. Pa suport (kontrata nr. 640/6 prot, datë 27.06.2018 ndërmjet UKL SH.A SHA dhe OE Y”, për periudhën 27.06.2018 – 26.06.2022 nuk ka përfshirë mirëmbajtjen e Sistemin e Faturimit “X”).

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A ka filluar përdorimin e Sistemit të Faturimit “X”, produkt i kontratës të nënshkruar midis FMO, Y dhe UKL SH.A. mbi projektin: “Instalimi i sistemit të matësive elektronikë”. Si rezultat i mosmarrëveshjeve me OE ky projekt ka ngelur i papërfunduar dhe sistemi i faturimit që po përdor UKL Sh.A është i pa regjistruar si aset dhe pa mirëmbajtje.

Ndikimi/efekti: Mos pasqyrim i saktë i pasqyrave financiare dhe risk në rezultatet financiare në UKL Sh. A.

Shkaku: Mos zbatimi i Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për “*Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit*”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për zarizimin e Sistemin e Faturimit “X” si dhe zbatimin të procedurave ligjore për sigurimin e suportit të mirëmbajtjes nëpërmjet marrëveshjes së nivel shërbimit.

3. Titulli i gjetjes UKL SH.A nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operationale në Sistemin e Faturimit “X” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “X” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKL SH.A .

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A nuk ka hartuar bazën rregullative të Sistemit të Faturimit “X” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “X” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKL SH.A

Ndikimi/efekti: Kryerja e veprimeve në bazën rregullative të Sistemit të Faturimit “X” për parametrizime të sistemit dhe për anulimin/ndryshimin e rekordeve në bazën e të dhënave pa procedura të miratuara mbart riskun e cënimit të sigurisë së sistemit me risk impakt negativ financiar për Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Shkaku: Mos zbatimi i Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Sistemit të Faturimit “X” dhe përditësimin e këtij manuali.

4.Titulli i gjetjes: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

Situata: Nivel i ulët organizativ i strukturës IT-së në UKL Sh. A me përbërje vetëm një specialist në vartësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, i cili kryen detyrat për mirëmbajtjen (help desk) e sistemit, postes elektronike, pajisjeve kompjuterike si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit në përbërje të njësisë së prokurimit dhe KVO, etj

Ndikimi/efekti: Risk në mos kryerjen e detyrave si rezultat i mbingarkesës dhe konfliktit të interesit në ndarjen e punës. Mos realizimin e objektivave institucionale, zbehje të ndikimit të IT në vendimmarrje.

Shkaku: Burime njerëzore të pa zhvilluara si rezultat i zhvillimit dhe menaxhimit të tyre pa një strategji mbi Teknologjinë e Informacionit në përgjithësi dhe burimet njerëzore në veçanti.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A në hartimin e strategjisë së Teknologjinë së Informacionit të parashikojnë strategji zhvillimi të burimet njerëzore IT në UKL Sh.A si një strukture të pa varur, pranë vendimmarrjes, të plotësuar me personel në vartësi të detyrave të ngarkuara në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e AKSHIT.

5.Titulli i gjetjes: Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve (Web Gis) i implementuar në UKL Sh.A. është populluar në një përqindje të ulët duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të gjithë pjesët përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKL. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar.

Situata: Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve Web-Gis në UKL është ndërtuar mbi një arkitekturën multrole dhe multuser. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të zarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin (vendin) e objektit. Nuk mund të gjenerojë raporte të plota për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxherët, punonjësit e ujësjetllësit, ashtu dhe për vizitorët (qytetarët).

UKL Sh. A. nuk ka përfunduar regjistrimin e aseteve në programin Web Gis. Ky sistem nuk përcakton vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi.

Ndikimi/efekti: Mos përdorim dhe menaxhim me efcienc, ekonomikiteti dhe efektivitet të aseteve të UKL Sh. A.

Shkaku: Mungesa në menaxhim nga Stafi i lartë Drejtues në implementim dhe shfrytëzim të Web-Gis në UKL Sh. A .



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKL Sh. A . të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në efencë të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit.

V. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014, nga data 03.09.2018 deri më datë 15.10.2018 zhvilloi një Auditim të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A (UKL Sh. A) është shoqëri aksionare e licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 40, datë 23.9.2016 deri me 22.09.2020), me kapital 100 % të Bashkisë Lushnje që zhvillon aktivitetin e saj në territorin e qytetit të Lushnjes.

Vizioni i Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. është njohja si një biznes i suksesshëm ujësjetllësi që vlerësohet nga komuniteti.

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. i kryen funksionet bazuar në:

1. Kodi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve.
2. Ligj Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
3. Ligj 8237 01.09.1997.
4. Vendim i KM 660 12.09.2007.
5. VKM 1304 dt.11.12.2009.
6. VKM nr.236 datë 10.05.1993 Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë i ndryshuar

UKL është përgjegjëse për:

- Për ofrimin e shërbim të qëndrueshëm ujësjetllësi në sasi të mjaftueshme dhe me cilësinë e duhur, në përputhje me standardet në fuqi dhe me çmim të arsyeshëm, për të gjithë konsumatorët.
- Për ofrimin e shërbimit e grumbullimit, trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura me qëllim që të ruajë shëndetin publik dhe në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit.
- Të administrojë shoqërinë në formën e një biznesi me qëllim që ajo të jetë financiarisht e qëndrueshme.
- Të investojë në rritjen e kapaciteteve të punonjësve të shoqërisë dhe në sigurimin për ta të kompensimit të drejtë për të nxitur interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët e shoqërisë.

Grupi i auditimit mblodhi informacione dhe zhvilloi analiza për caktimin e zonave me risk të lartë mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Plani i auditimit i dalë nga informacionet dhe analizat paraprake kishte për objektiv vlerësimin e sistemeve TI, dhe aspekteve që lidhen me mirëmbajtjen, zhvillimin dhe sigurinë e tyre. Mbështetur për sa më lart janë mbajtur aktet përkatëse të auditimit, janë shqyrtuar observacionet të cilat gjenden të reflektuara në këtë Raport, gjithashtu kemi propozuar rekomandimet përkatëse.

VI. REZULTATET E AUDITIMIT

VI.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK


1.a/1 Vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

Objektivi i Auditimit:

Auditimi i sistemeve TI u krye me objektivin për tu garantuar nëse ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat në strukturat IT që mundësojnë Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A. të arrijë objektivat në funksion të plotësisimit të misionit.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A (UKL Sh. A .) është shoqëri aksionare e licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me kapital 100 % të Bashkisë Lushnje që zhvillon aktivitetin e saj në territorin që shtrihet në lindje të fushës së Myzeqesë, buzë kodrave të Darsisë me një sipërfaqe prej 37 km² për një popullsi prej rreth 60000 banorë.



Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet nga dy zona të ndryshme fushë-pusesh të pavarura:

- Sistemi i Lushnjes furnizohet nga fusha e puseve dhe stacioni i pompimit të Konjtit
- Sistemi i Dushkut furnizohet nga fusha e puseve dhe stacioni i pompimit të Çermës

Rrjeti urban i shpërndarjes së Ujit në Lushnje ka një gjatësi totale prej 72 km, nga të cilat 17 km janë tubacione transmetimi dhe 55 km janë rrjet shpërndarjeje.

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1304, datë 11.12.2009 për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës kanalizimeve sh.a.”

Drejtori i përgjithshëm, në rolin e Administratorit, emërohet nga Kryetari i Bashkisë Lushnjë, i cili ka autoritetin të emërojë edhe një Drejtor Ekonomik dhe një Drejtor Teknik. Të gjitha funksionet e shoqërisë kontrollohen nga këta dy drejtorë.




KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. është gjithsej 211 punonjës .

Në figurën e mëposhtme paraqitet struktura organike e Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.



Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit përbehet nga një rrjet network në zyrat qendrore të UKL Sh. A. me akses dhe shpërndarje të internetit si dhe me një ambient të improvizuar si dhomë serverësh ku janë vendosur pajisjet aktive të rrjetit, si server back up, switch etj.

Burimet njerëzore dhe struktura e organizimit te tyre

UKL Sh. A ka vetëm një Specialisti i IT i cili është pjesë përbërëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Titulli i gjetjes: UKL Sh. A nuk ka rregullore për strukturën IT, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e back up, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj.

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka hartuar bazën rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike).

Ndikimi/efekti: Mos realizim të objektivave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e



strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve t, dokumentacion mbi procedurat e back up etj.).

2. Titulli i gjetjes: Nuk ka një analizë të nevojave për trajnim të stafit IT.

Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit.

Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

Situata: Nga auditimi rezultoi se UKL për vitin 2018 ka kryer 2 trajnime për sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre.

Ndikimi/efekti: Mos realizimin e objektivave institucionale.

Shkaku: Mos kryerja e analizës së nevojave për trajnim, mos hartimit dhe zbatimit të planit të trajnimeve nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe struktura IT, mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe IT të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

3. Titulli i gjetjes: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

Situata: Nivel i ulët organizativ i strukturës IT-së në UKL Sh. A me përbërje vetëm një specialist në vartësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, i cili kryen detyrat për mirëmbajtjen (help desk) e sistemit, postes elektronike, pajisjeve kompjuterike si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit në përbërje të njësisë së prokurimit dhe KVO, etj.

Ndikimi/efekti: Risk në mos kryerjen e detyrave si rezultat i mbingarkesës dhe konfliktit të interesit në ndarjen e punës. Mos realizimin e objektivave institucionale, zbehje të ndikimit të IT në vendimmarrje.

Shkaku: Burime njerëzore të pa zhvilluara si rezultat i zhvillimit dhe menaxhimit të tyre pa një strategji mbi Teknologjinë e Informacionit në përgjithësi dhe burimet njerëzore në veçanti.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A në hartimin e strategjisë së Teknologjinë e Informacionit të parashikojnë strategji zhvillimi të burimeve njerëzore IT në

UKL Sh. A si një strukture të pa varur, pranë vendimmarrjes, të plotësuar me personel në vartësi të detyrave të ngarkuara në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e AKSHIT..



Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.1, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës me komentet dhe shënimet pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.2. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.

1.a./2 Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK

Objektivi i Auditimit:

Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK u krye me objektiv për të konfirmuar nëse ekziston një strategji IT, e cila përfshin planin e IT dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, dhe zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, e cila është e lidhur me strategjinë dhe objektivat e Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. Risqet dhe burimet gjatë përmbushjes së objektivave të IT janë të menaxhuara efektivisht.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 40, datë 23.9.2016, “Për licencimin e Sh. A. Ujësjetllës-Kanalizime Lushnjë”, e zhvillon aktivitetin e saj në territorin e qytetit të Lushnjes.

Vizioni i Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. është njohja si një biznes i suksesshëm ujësjetllësi që vlerësohet nga komuniteti.

Qëllimet strategjike të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. përfshijnë:

- Të ofrojë shërbim të qëndrueshëm ujësjetllësi në sasi të mjaftueshme dhe me cilësinë e duhur, në përputhje me standardet në fuqi dhe me çmim të arsyeshëm, për të gjithë konsumatorët.
- Të ofrojë shërbimin e grumbullimit, trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura me qëllim që të ruajë shëndetin publik dhe në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit.
- Të administrojë shoqërinë në formën e një biznesi me qëllim që ajo të jetë financiarisht e qëndrueshme.
- Të investojë në rritjen e kapaciteteve të punonjësve të shoqërisë dhe në sigurimin për ta të kompensimit të drejtë për të nxitur interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët e shoqërisë.

Një vend të rëndësishëm në objektivat vjetore të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., është implementimi i infrastrukturës së përshtatshme IT për ofrimin e shërbimeve të planifikuara për të gjithë qytetarët si dhe specialistët e Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Nga Auditimi u konstatua se:

1. **Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Situata: Teknologjia e informacionit zhvillohet pa Plan Strategjik.

Ndikimi/efekti: Mos efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të investimeve IT për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

2. **Titulli i gjetjes** Standartet e Praktikave më të mira rekomandojnë që Qeverisja TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit dhe mund t'i referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikave duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT. Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka vendosur politika e parime mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve dhe politikave të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

Situata: Nuk janë krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të rregulloreve dhe politikave të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit

Ndikimi/efekti: Mos realizim të objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos përdorimi i mjeteve të komunikimit si intranet etj.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., të marrin masa për familjarizimin me rregulloret dhe politikave TIK për të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.2, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.3. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.

1.b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve me impakt në ofrimin e shërbimit.



Objektivi i auditimit: Verifikimi se të gjithë risqet e lidhur më sigurinë e informacionit janë identifikuar dhe se ekziston një strategji e përshtatshme për reduktimin e riskut.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka hartuar një regjistër për risku për teknologjinë e informacionit, dokumentet ruhen pa politika të paracaktuara nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, incidentet trajtohen mbi bazë ngjarjesh.

Gjetje nga Auditimi :

1. Titulli i gjetjes

1.1 Titulli i gjetjes Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

1.2 Titulli i gjetjes Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

1.2 Titulli i gjetjes Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme.

Situata: Mos menaxhim i incidenteve, mos identifikim dhe vlerësim i risqeve IT, mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A në bashkëpunim me specialistin e IT të marrin masa për:

- a. Monitorimin e risqeve në infrastrukturën IT nëpërmjet identifikimit, prioritarizimit hartimit të një plan veprimi për minimizimin e tyre.
- b. Dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve në infrastrukturën IT.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

c. Menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.3, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.4. Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit

2.a Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH)

Objektivat e auditimit:

- Vlerësimi nëse agjencia ka zhvilluar një marrëveshje të detajuar në nivel shërbimi së bashku me të gjitha kërkesat dhe nëse është aktivisht monitoruese ndaj shoqërisë ofruese.
- Vlerësimi nëse kërkesat e sigurisë janë adresuar në prokurim dhe janë në përputhje me to.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Për gjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2018, periudhë mbi të cilën Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë Sh. A. (UKL) është nën auditim, ka kryer identifikimin, planifikimin dhe pajisjen me mallra dhe shërbime në fushën e IT, nga drejtoritë përkatëse.

Gjatë hartimit të Planit Ekonomik 2018-2022 të UKL Sh. A., personat përgjegjës të hartimit të këtij plani kanë marrë për bazë këto nevoja dhe kanë bërë të mundur priorizimin e tyre duke marrë parasysh dhe të ardhurat.

Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH).

Ujësjellës-Kanalizime Lushnje Sh. A. për periudhën 01.01.2018-31.12.2018 ka aktive të lidhura **3** kontrata të **Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit**:

- a. Kontrata nr. 3, datë 08.02.2018 me objekt “Sistemi Web-Gis për Ujësjellës Kanalizime Lushnje” me fitues operatorin ekonomik “Z” sh.p.k.
- b. Kontrata nr.5, datë 08.02.2018, me objekt “Azhurnimi i sistemit aktual Alpha” me fitues operatorin ekonomik “A” sh.p.k.
- c. Kontratë nr. 640/6, datë 27.06.2018, me objekt “Për programin e shitjes, blerjen e aparaturave në funksion të këtij programi dhe shërbimi i mirëmbajtjes për 4 vjet” me fituese Operatorin Ekonomik “Y” sh.p.k.

Gjetjet nga Auditimi:

1. Titulli i gjetjes: Strukturat e IT-së nuk janë përfshirë në procesin e identifikimit të nevojave si dhe nuk përfshihen në procesin e menaxhimit të tyre.

Situata: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka kryer procesin e identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit por kjo në mungesë të strukturës të IT.

Ndikimi/Efekti: Mosfunksionimi i strukturës së IT-së sjell pasoja negative në mbarëvajtjen e procesit të identifikimit dhe menaxhimin të nevojave për investime në fushën e teknologjisë dhe informacionit.



Shkaku: Mungesa e strategjisë TIK.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e strukturës IT, e cila (krahas kryerjes së detyrave funksionale) do të kryejë analizimin, prioritarizimin dhe planifikimin e nevojave për sistemet e reja dhe ekzistuese të Teknologjisë së Informacionit.

2. Titulli i gjetjes: Kontratat MNSH të lidhura nga UKL. Sh. A me OE “Z” sh.p.k., OE “A” sh.p.k dhe OE “Y” sh.p.k, për mirëmbajtjen e sistemeve respektivisht janë hartuar në mos përputhje me pikën nr.6 të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” (Kontrata e MNSH nuk është aneks më vete dhe nuk përmban përcaktimet e udhëzimit të mësipërm për matjen e nivelit të shërbimit)

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. gjatë hartimit të kontratave të prokurimeve në fushën e teknologjisë dhe informacionit, nuk kanë bërë të mundur bashkëngjitjen e kontratës së Marrëveshjes në Nivel Shërbimi si aneks i kontratës administrative.

Ndikimi/Efekti: Mos matjen e nivelit të kryerjes së shërbimit me risk mos funksionim të sistemeve.

Shkaku: Hartimi i kontratave MNSH jo në përputhje Udhëzimin nr. 1159, datë 17.03.2014

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të hartojë e zbatojë Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

3. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) respektivisht kontratën nr. 3 me fitues operatorin ekonomik “Z” sh.p.k., kontratën nr.5 me fitues operatorin ekonomik “A” sh.p.k. dhe kontratën nr. 640/6 me fituese Operatorin Ekonomik “Y” sh.p.k, ka një mangësi në procesin e vlerësimit të shërbimit (*Kolaudimin*) kur dihet që përfundimi i implementimit të çdo projekti shoqërohet me kolaudime të pjesshme ose me një **analizë kosto-përfitim (matja e cilësisë së shërbimit)** për kontratën nr.3 dhe 5 si dhe z. për kontratën nr. 640/6 sipas udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike” **pjesa III pika 10 Aneksi 2** dhe sipas **pikës 8 (ç)** të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. gjatë kohës që ka përfituar shërbimin nuk ka zhvilluar ndonjë analizë për të përcaktuar cilësinë e shërbimit të marrë, mbi mënyrën e përdorimit të këtij shërbimi dhe gjithashtu mbi vlefshmërinë e këtij shërbimi.

Ndikimi/Efekti: Mos analizimi i këtyre shërbimeve sjell që këto shërbime të mos jenë efektive dhe të ndodhin incidente të papritura.

Shkaku: Mos zbatim i legjisllacionit përkatës dhe inekzistenca e një strukture në institucion që të kujdeset për këto shërbime.

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa përkatëse për ngritjen e një strukture të posaçme që të bëjë të mundshme shoqërimin me kolaudime të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

pjesëshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.

4. Titulli i gjetjes: UKL Sh. A. në kontratat nr.5 me OE “A sh.p.k. dhe nr.640/6 me OE “Y” sh.p.k, nuk ka zbatuar rregullat dhe procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimit sipas *Udhëzimit nr. 2*, datë 02.09.2013 “*Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike*” **pjesa III pika 10 Aneksi 2** dhe sipas **pikës 8 (dh)** të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për Hartimin e MNSH*”

Situata: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. gjatë kohës që ka lidhur kontratat nuk ka përcaktuar rregulla dhe procedura për marrjen në dorëzim të shërbimit sipas *Udhëzimit nr. 2*, datë 02.09.2013 “*Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike*” **pjesa III pika 10 Aneksi 2** dhe sipas **pikës 8 (dh)** të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për Hartimin e MNSH*”

Ndikimi/Efekti: Humbje e të dhënave, mos realizim të detyrave, dëmtim i imazhit të UKL Sh. A.

Shkaku: Mos kryerja e detyrave funksionale menaxheriale.

Rekomandim: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa ligjore për caktimin e personave përgjegjës dhe informacionin e kontaktimit të tyre për zbatimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve duke dokumentuar procesin monitorues.

5. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i Kontratës **nr.5** me fitues Operatorin Ekonomik “A sh.p.k. me Administrator z. dhe **nr.640/6** me fituese Operatorin Ekonomik “Y” sh.p.k me administrator z. , u konstatua se nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi*. Përgjegjës për hartimin dhe firmosjen e këtyre kontratave janë respektivisht për kontratën nr.5 z. administrator i subjektit dhe për Kontratën nr.640/6 z. administrator i subjektit.

Kjo në kundërshtim me **pikën 7** të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për “*Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit*”.

Situata: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. gjatë kohës që ka hartuar kontratat e prokurimeve, në pjesën e të drejtave dhe detyrimeve të të dy palëve ka mangësi të theksuara të mospërfshirjes së kohës së raportimit, kohës së përgjigje, prioritetit dhe përshkallëzimit.

Ndikimi/Efekti: Risku që të ndodhin incidente është i lartë dhe zgjidhja e këtyre incidenteve mund të ndodhi në një kohë relativisht të gjatë.

Shkaku: Mosnjohja me ligjin përkatës dhe neglizhenca e krijuar nga personat përgjegjës.

Rekomandim: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit të marrë masat përkatëse për përfshirjen në kontrata të kohës së raportimit, kohës së përgjigjes, prioritetit dhe përshkallëzimeve në seksionin e të drejtave dhe detyrimeve në mënyrë që të zgjidhen kërkesat dhe të shmangen incidentet e mundshme që të zbatojë Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.



Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.4, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.5. Auditimi i Sigurisë së Informacionit.

3.a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e tyre.

Objektivi i auditimit: Verifikimi se të gjithë risqet e lidhur më sigurinë e informacionit janë identifikuar dhe se ekziston një strategji e përshtatshme për reduktimin e riskut.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Auditimi mbi Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, dt. 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, risqeve të identifikuar dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve tek qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet këtyre sistemeve, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemit të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave.

Gjetje nga Auditimi :

- 1. Titulli i gjetjes** Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.
- 2. Titulli i gjetjes** Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. kryen back-up të bazës së të dhënave po në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (dhoma e serverëve).

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në bashkëpunim me Specialistin e IT të marrin masa për miratimin e një plani për emergjence dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit.



3. Titulli i gjetjes Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve , aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKL Sh. A .

4. Titulli i gjetjes Siguria e infrastrukturës network në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A. është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, paisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.
- b. Server të dedikuar per CA (Certificate Authority)
- c. Server i dedikuar për mail server (Exchange server)
- d. Firewall Hardware
- e. Switch të menaxhueshëm

Situata: Infrastrukturë pa nivel sigurie.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mungesë e investimeve

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marri masat për t’u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.; server të dedikuar për CA; Server i dedikuar për mail server, Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.5, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.6. Auditimi i Sigurisë së Informacionit.

3.b. Të drejtat e përdoruesit dhe menaxhimi i tyre

Informacion i Përgjithshëm

UKL Sh. A . (Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A .) për arritjen e objektivave dhe eficientë e punës përdorë tre sisteme : Al-Billing, Web-Gis, Alpha-Web.

- Nëpërmjet AL-Billing administrohet sistemi, informacioni i abonentëve si dhe specifikave të tyre, administrohet procesi i faturimit, tarifimit, procesi i arkëtimit, procesi i kërkesë/ankesave.

Për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018 përdorues aktivë të AL-Billing



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

- Web-Gis është një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale në të cilin paraqitet e gjithë harta e kanalizimeve ,me anë të tools-ave kjo hartë mund të krijohet,fshihet dhe modifikohet nga punonjësit që kanë akses

Përdorues Sistemi Web-Gis :

- Alpha-Web është program kompjuterik për administrimin dhe kontrollin e plotë të një ndërmarrje dhe degëve të saj të ndodhura në largësi, kontrollon ecurinë e ndërmarrjes nëpërmjet raporteve lehtëson punën e regjistrimit dhe përpunimit të dokumenteve të shitjes, blerjes, arkës, bankës, magazinës, doganës, pagave.

Për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018 përdorues aktivë të Sh. A UKL-së janë :

Autorizimi i zotëruesit të dhënave sesi informohen përdoruesit mbi përgjegjësitë e tyre në mbrojtjen e informacionit sensitiv ose të aseteve, nëse u është dhënë akses i përkatës dhe akses i informacionit në nivel me përgjegjësinë e punës.

Nga Auditimi u konstatua se:

1.1 Titulli i gjetjes Hapja dhe ndalimi i aksesit të informacionit për personat e punësuar apo pushuar ose të transferuar nga puna monitorohet dhe nuk shoqërohet me një procesverbal për të vërtetuar që akses i informacionit është ndaluar në kohën e duhur për të shmangur humbjen ose keqpërdorimin e informacionit. Krijimi dhe fshirja e userave (përdoruesve) bëhet verbalisht nga administruesit e programeve përkatës.

1.2 Titulli i gjetjes UKL Sh. A . nuk ka procedura për të përcaktuar akseset dhe privilegjet e përdoruesve në mënyrë që përdorimi i informacionit të jetë në përshtatje me nivelin dhe pozicionin e punës, duke qenë se programet janë ndërtuar mbi arkitekturën multirole dhe multiuser duke pasur mundësi krijimi apo akses i informacionit në aplikacion.

Situata: UKL Sh. A . regjistrimin, fshirjen e llogarive, ndarjen e roleve në program nuk dokumentohet (kryen verbalisht) duke mos gjurme nëse puna është kryer e saktë dhe në kohën e duhur.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave, mos aksesim i duhur në informacion.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: UKL Sh. A . duhet të hartojë rregulla dhe procedura për krijimin dhe fshirjen e përdoruesve për personat e punësuar dhe ata të larguar ose transferuar, ndarjen e duhur të roleve në program për aksesin në informacion.

2. Titulli i gjetjes Nuk kryhen ndryshime sistematike të fjalëkalimeve (minimalisht 60 ditë) , e përcaktuar dhe në manualin e përdorimit të programit Al-Billing , në mënyrë që ruajtja e të dhënave të jetë më e sigurt duke ulur mundësinë e hyrjeve të paautorizuara në të dhënat e sistemit

Situata: Ndërrimi i fjalëkalimeve nuk kryhet në afate kohore të caktuara



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje e të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave të mira.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: UKL Sh. A . duhet të ndjekë procedura për përdoruesit e programeve në mënyrë që ndryshimi i fjalëkalimeve të kryhet sistematikisht.

3. Titulli i gjetjes Referuar ligjit nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” i ndryshuar, deklarata e Konfidencialitetit për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e informacionit sensitiv nuk përkon me datën e fillimit të punës së punonjësve që kanë akses në të dhënat e sistemit .

Situata: Deklaratat e konfidencialitetit të gjithë punonjësve kanë të njëjtën datë nënshkrimi.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Punonjësit e UKL Sh. A . duhet të firmosin deklaratat e konfidencialitetit në kohën që kanë akses në të dhënat e programeve që disponojnë.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.6, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.7. Auditimi i sistemeve të matjes dhe faturimit

4.a. Verifikim i kontrolleve të Aplikacioneve për të dhënat Input/Output

Objektivat e auditimit:

- A është i përshtatshëm menaxhimi i dokumenteve burimorë dhe i mbledhjes së të dhënave?
- A përmban aplikacioni “X” procedura të përshtatshme për trajtimin e gabimeve?
- Si menaxhohet autorizimi i futjes së të dhënave në aplikacion?
- Vlerësimi nëse informacioni i aplikacionit “X” është i sigurt kundrejt keqpërdorimeve.

Informacion i Përgjithshëm

UKL Sh. A . ka përdorur për faturim programin WaterBilling (ngelur pa suport pas përfundimit të kontratës) dhe administruar nga Dep. Shitjes.

Nga muaji maj i vitit 2017 UKL Sh. A . ka nisur përdorimin e Sistemi i Faturimit “X” prodhim i kompanisë “E shpk” si rezultat i kontratës së kësaj të fundit me FMO (menaxhim dhe mirëmbajtje Y / Admin sistemi Drejtoria Tregtare e UKL Sh. A .).

Nëpërmjet këtij sistemi faturimi administrohet:

- Informacioni i abonentëve,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

- Procesi i faturimit, tarifimit,
- Procesi i arkëtimit,
- Procesi i kërkesë/ankesave,
- Administrohet posta elektronike,
- Të tjera.

Përdoruesit aktivë të Sistemit “X” për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018:

Programi kryen administrimin e përdoruesve si dhe gjurmimin e aktivitetit të tyre

Të gjithë përdoruesit e sistemit pas identifikimit kanë të drejta në proceset e përcaktuara.

UKL Sh. A . nëpërmjet sistemit “X” për vitin 2018 ka krijuar 26522555 rekorde për 25167 Abonentë në ujësjellës kanalizime të klasifikuar në 16 kategori si vijon:

| KATEGORI ABONENTI | Nr. |
|----------------------|-------|
| Komuna | 3 |
| Familjar K | 6 |
| Familjar U pa Takse | 10 |
| Private K | 27 |
| Familjar UK pa Takse | 32 |
| Institucione U | 51 |
| ZeB Private UK | 54 |
| Institucione UK | 61 |
| LF Institucione U | 76 |
| Private U | 117 |
| LF Private U | 190 |
| Private UK | 1246 |
| Familjar U | 2449 |
| ZeB Familjar UK | 3781 |
| LF Familjar U | 6778 |
| Familjar UK | 10286 |

Në përfundim të procesit çdo muaj sistemi gjeneron faturën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”



Ujësjetllës Kanalizime Sh. A. Lushnje
 NIS: 894223485T
 Lagja "Lori Dharmo" Lushnje
 Tel/Fax: 035222189
 E-mail: uksh.lushnje@gmail.com



FATURË TATIMORE SHITJE SHTATOR 2018 (date: 30.09.2018)

KOPJE ELEKTRONIKE

QAMIL KAJA
 Lagje: Lori Dharmo
 Kod abonenti: 5467, Faturisti: 1
 Familjar Uje+Kanalizime

Numër Klienti: 100157
 Numri Serial: 211325319
 Periudhë Faturimi: SHTATOR 2018
 Seriali i Matësit: 1307210316
 Numri i Vullës: 0

| PËRSHKRIMI | NJËSIA | SASIA | ÇMIMI | VLERA (LEKE) |
|---|----------------|-------|-------|---------------|
| Ujtë i përshtet (të cilin aktual: 63 - Isolin i ndarshëm: 40) | | | 4.00 | |
| Ujtë i përshtet | m ³ | 4.0 | 68 | 232.00 |
| Largim i ujit të përdorur | | | | |
| Largim i ujit të përdorur | m ³ | 4.0 | 17 | 68.00 |
| Tarifë Fajrimi | | | | 100.00 |
| Vendosje ujmatësi, presje, rritje, rrucoje, globe | | | | |
| Vlera (LEK) | | | | 400.00 |
| TVSH (20%) | | | | 80.00 |
| Tarifë Sherbimi Komunitar (Pastrim, Nidriom, Gjellberim) | | | | 200.00 |
| Taksa Nderkese | | | | 301.00 |
| Taksa Trualli | | | | 0.00 |
| Kompensim | | | | 0.00 |
| Kamata | | | | 0.00 |
| Faturimi muaji SHTATOR 2018 (mumbulakimi para 0 dhe aktual: 0) | | | | 981.00 |

DEYRIMI I PRAPAMBETUR (deri më datë 06.02.2019) **619.49**
 (fatura duhet paguar deri më datë 26.10.2018, pas kalimit të kësaj date do të aplikohet kamata 0.2% në ditë deri në vlerën prej 10% të fakturës).
 Përdorimi i kësaj fature është i lejuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me autorizimin Nr. 13418/2, datë 12.07.2017
 Fatura është thirrë ekspozitivisht sipas Ligjit Nr. 8975, datë 21.11.2002

| QAMIL KAJA | | Numër Klienti: | 100157 |
|--|--|----------------|---------------|
| Lagje: Lori Dharmo | | Numri Serial: | 211325319 |
| Vlera (LEK) | | | 400.00 |
| TVSH (20%) | | | 80.00 |
| Taksa Lokale | | | 501.00 |
| Kompensim | | | 0.00 |
| Kamata | | | 0.00 |
| Faturimi muaji SHTATOR 2018 | | | 981.00 |
| DEYRIMI I PRAPAMBETUR (deri më datë 06.02.2019) | | | 619.49 |

(fatura duhet paguar deri më datë 26.10.2018, pas kalimit të kësaj date do të aplikohet kamata 0.2% në ditë deri në vlerën prej 10% të fakturës)



Nga auditimi rezultoi se:

1. Titulli i gjetjes:

UKL SH.A nuk ka kryer (për periudhën nën auditim 1.01.2018-31.12.2018) procedurat për miratimin e faturës tatimore duke lejuar gjenerimin nga sistemi “X” të faturave me TVSH pa kod fiskal.

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A ka printuar fatura tatimore të pa miratuara (për periudhën nën auditim 1.01.2018-31.12.2018).

Ndikimi/efekti: Mos realizimin e objektivave institucionale.

Shkaku: Mos zbatim i ligjeve fiskale.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për miratimin e faturës tatimore.

2. Titulli i gjetjes:

UKL Sh. A .përdor Sistemin e Faturimit “X”

a. Të pa regjistruar si aset

b. Pa suport (kontrata nr. 640/6 prot. datë 27.06.2018 ndërmjet UKL Sh. A .dhe OE “Y”, për periudhën 27.06.2018 – 26.06.2022 nuk ka përfshirë mirëmbajtjen e Sistemin e Faturimit “X”).

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A ka filluar përdorimin e Sistemit të Faturimit “X”, produkt i kontratës të nënshkruar midis FMO, Y dhe UKL Sh. A .mbi projektin: “Instalimi i sistemit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

të matësive elektronikë”. Si rezultat i mosmarrëveshjeve me OE ky projekt ka ngelur i papërfunduar dhe sistemi i faturimit që po përdor UKL Sh. A është i pa regjistruar si aset dhe pa mirëmbajtje.

Ndikimi/efekti: Mos pasqyrim i saktë i pasqyrave financiare dhe risk në rezultatet financiare në UKL Sh. A.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për “*Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit*”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh.A të marrin masa për zarizimin e Sistemin e Faturimit “X” si dhe zbatimin të procedurave ligjore për sigurimin e suportit të mirëmbajtjes nëpërmjet marrëveshjes së nivel shërbimit.

3. Titulli i gjetjes:

Në Sistemin e Faturimit “X” janë kryer veprime për sistemime duke gjeneruar 458403 dublikata në fushën ID për të cilat nuk mbahet dokumentacion për argumentimin e tyre.

Më hollësisht:

Përdoruesit dhe veprimet në bazën e të dhënave që kanë krijuar dublikata

Shpërndarja e Dublikatave sipas zonave

| ZONA_OLD | NO_OF_RECS |
|--------------------------|------------|
| | 2 |
| ALLKAJ | 1295 |
| ALLKAJ - 1 | 128 |
| ALLKAJ - ALLKAJ | 289 |
| ALLKAJ - DELISUFAJ | 3714 |
| ALLKAJ - MAZHAI | 1451 |
| ALLKAJ - TOSHKEZ | 5460 |
| ALLKAJ - ZHELIZHAN | 4713 |
| ALLPRENAJ | 613 |
| BALAJ | 1719 |
| BALLAGAT | 1793 |
| BICAKAJ | 1819 |
| BICAKAJ-GJOLENE | 938 |
| BISNESI PRIVAT | 20254 |
| BUBULLIME | 6692 |
| BUBULLIME - 1 | 209 |
| BUBULLIME - ESKAJ | 3222 |
| BUBULLIME - GJONAS | 2587 |
| BUBULLIME - HALILAJ | 3867 |
| BUBULLIME - IMSHT | 7146 |
| BUBULLIME- BUBULLIME1 | 2242 |



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

| | |
|----------------------|-------|
| CANAKAJ | 769 |
| CENTRALI | 14229 |
| CINAR | 1383 |
| CUKAS I RI | 479 |
| DEGA | 4474 |
| DUSHK FSHAT | 1710 |
| DUSHK SEKTOR | 7210 |
| FIERSHEG.-BARBULLINJ | 4808 |
| FIERSHEGAN | 4868 |
| FIERSHEGAN-1 | 89 |
| FIERSHEGAN-BICAKAJRI | 692 |
| FIERSHEGAN-CUKAS VJ | 1997 |
| FIERSHEGAN-KADIAJ | 1110 |
| FIERSHEGAN-KOCAJ | 901 |
| FIERSHEGAN-QERRET RI | 1051 |
| FIERSHEGAN-QERRET VJ | 3113 |
| GARUNJAS | 1298 |
| GJYSHAJ | 1258 |
| GOLEM | 4160 |
| HAJDARAJ | 2337 |
| HEKURUDHA 1 | 9254 |
| HEKURUDHA 2 | 9038 |
| HYSGJOKAJ | 1819 |
| Institucione Buxh. | 1625 |
| KADRI-QYSTRI | 14379 |
| KARBUNARE | 6954 |
| KARBURANTI | 2102 |
| KASHARAJ | 743 |
| KINOTEATRI | 8214 |
| KODRA 1 | 6427 |
| KODRA 2 | 5462 |
| KOLONJE - BISHQETHEM | 2198 |
| KOLONJE - GORRE | 4324 |
| KOLONJE - KAMCISHT | 3944 |
| KOLONJE - KOLONJE | 6390 |
| KOLONJE - LUMTH | 2361 |
| KOLONJE - PIRRE | 4713 |
| KOLONJE - RRAPEZ | 5249 |
| KOLONJE - SHAKUJ | 1300 |
| KOLONJE - VANAJ | 278 |
| KONGRESI | 7189 |
| KONJAT | 1606 |
| KOSOV E VOGEL | 711 |
| KRUTJE - 1 | 244 |



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

| | |
|--------------------|-------|
| KRUTJE - ARREZ | 2123 |
| KRUTJE - FIER I RI | 2672 |
| KRUTJE - GJAZE | 2760 |
| KRUTJE - KRUTJE | 590 |
| KRUTJE - KRUTJE PO | 5576 |
| KRUTJE - KRUTJE SI | 4982 |
| KRUTJE - LIFAJ | 2410 |
| KRUTJE - N MADHE | 6064 |
| KRUTJE - N VOGEL | 2827 |
| KRUTJE - RRUPAJ | 3374 |
| KRUTJE - ZHYM | 1149 |
| KUPAS | 654 |
| KURTIN | 1689 |
| LEKAJ | 653 |
| LETRA | 9485 |
| MATJAN | 631 |
| MURRIZ | 801 |
| MURRIZ-PEQIN | 1265 |
| N.SH.N. 1 | 6028 |
| NAFTA 1 | 6877 |
| NAFTA 2 | 4471 |
| NSHN 2 | 3929 |
| PALLATI KOMUNAL | 7704 |
| PARAFABRIKAT 2 | 8975 |
| PARAFABRIKATI 1 | 7373 |
| PARTIZAN 1 | 12720 |
| PARTIZAN 2 | 12109 |
| PERIMORE | 6633 |
| PLUG 1 | 7771 |
| PLUG 2 | 7659 |
| Poshnje | 150 |
| Poshnje - Agim | 1266 |
| Poshnje - Hinge | 2901 |
| Poshnje - Kuc | 970 |
| QENDRA | 13601 |
| SARAVA | 9654 |
| SARAVA VERES | 5187 |
| SAVER | 6231 |
| SEJMEAZ | 925 |
| SHEGAS | 1931 |
| SKILAJ | 1103 |
| SPITALI | 5163 |
| STANI ALBANES | 5341 |
| STANI CIMIT | 5928 |




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

| | |
|------------|-------|
| THANE | 2436 |
| VIROVE | 1730 |
| XIBRAK | 926 |
| ZDRUKTARIA | 10107 |
| ZGJANE | 1097 |
| ZHAME | 5189 |

Shpërndarja e dublikatave sipas muajve



Përdoruesit dhe veprimet në bazën e të dhënave që kanë krijuar dublikata)

Situata: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A në Sistemin e Faturimit “X”, kanë kryer sistemime dhe janë gjeneruar ID dublikata dhe jo ID të reja. Për këtë proces pune nuk është mbajtur asnjë dokumentacion argumentues.

Ndikimi/efekti: Mbivendosje të dhënash, impakt në të dhënat financiare.

Shkaku: Mos hartimi i rregulloreve mos ndarje të detyrave dhe mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për të mos krijuar dublikate. UKL Sh. A. duhet të dokumentojë çdo proces pune mbi ndryshimet dhe sistemimet.

4. Titulli i gjetjes:

Në Sistemin e Faturimit “X” janë kryer veprime për sistemime nga përdoruesit “import” dhe “ora IMPORT” që nuk figurojnë në listën e përdoruesve por kanë gjeneruar respektivisht 8 dhe 4838 veprime me pasojë krijim dublikata.

Situata: Dy përdorues të sistemit të Faturimit “X”, nuk janë në listën e përdoruesve të UKL Sh. A. Këta përdorues kanë gjeneruar veprime dhe sistemime duke krijuar dublikata.

Ndikimi/efekti: Mbivendosje të dhënash. Përdorues të pa autorizuar me impakt financiar

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A të gjejë përgjegjësit për dy përdoruesit e mësipërm.

5. Titulli i gjetjes:

Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “X” për periudhën 01 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 12247 “Hendeqe” në fushën ID. (bashkëlidhur këtij akt konstatimi rekordet me hendeqe në fushën ID).

Situata: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A në Sistemin e Faturimit “X”, kanë kryer sistemime dhe janë gjeneruar ID me Hendeqe .

Ndikimi/efekti: Fshirjen e gjurmëve të auditimit me impakt në të dhënat financiare.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh.A të analizojnë situatën dhe të marrin masa për të mos lejuar kryerjen e sistemimeve në bazat e të dhënave nëpërmjet fshirjes së rekordeve.

6. Titulli i gjetjes: UKL Sh. A .nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operationale në Sistemin e Faturimit “X” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “X” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKL Sh. A .

Situata: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A nuk ka hartuar bazën rregullative të Sistemit të Faturimit “X” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “X” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKL Sh. A

Ndikimi/efekti: Kryerja e veprimeve në bazën rregullative të Sistemit të Faturimit “X” për parametrizime të sistemit dhe për anulimin/ndryshimin e rekordeve në bazën e të dhënave pa procedura të miratuara mbart riskun e cenimit të sigurisë së sistemit me risk impakt negativ financiar për Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Shkaku: Mos zbatimi i Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Sistemit të Faturimit “X” dhe përditësimin e këtij manuali.

7. Titulli i gjetjes:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

UKL Sh. A nuk ka të drejta mbi kodin në burim në Sistemin e Faturimit “X” kompania “E shpk” është pronare dhe administratore e këtij sistemi (përdoruesi Ariola Korreshi është user me të drejta të plota).

Situata: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka akses të plot në Sistemin e Faturimit “X”. E shpk është pronare e sistemit por luan edhe rolin e administratorit edhe pse UKL Sh.A. ka një user me të drejta të plota.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje dhe ndryshim të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i kontratës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të ketë një punonjës si administrator të sistemit dhe të ketë të drejta të plota mbi kodin në burim të Sistemit të Faturimit.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.7, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës me komentet dhe shënimet pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.8. Të ndryshme

Objektivi: Verifikimi i shkallës së përdorimit të Teknologjisë së informacionit në funksion të arritjes së objektivit të përgjithshëm të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje, për përdorimin në mënyrë sa më eficiente të burimeve, për rritjen e sigurisë, uljen e kostos, rritjen e efektivitetit.

Informacion i përgjithshëm

Aktivitetet Kryesore të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje:

-Shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij.

-Mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm



-Prodhimin dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve

-Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij.

-Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre

Sistemi i Ujësjetllës të Lushnjes , përbëhet nga pompat ,puset e ujit, linjat e transmetimit, nëpërmjet të

cilave uji akumulohet në depo dhe më pas kalon në rrjetin shpërndarës të furnizimit me ujë të qytetit dhe fshatrave përreth tij . UKL Sh. A . ka si stacionin e saj kryesor të pompimit atë të Konjatit i cili është i përbërë nga gjashtë puse funksionale Pompistët përdorin komunikimin me radio për fikjen dhe ndezjen e pompave për secilin prej puseve. Ambienti është i rrethuar dhe i ruajtur me roje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

private. “Komandimi” për komunikimin me punonjësit në stacione dhe depo është e përbërë nga një person i vetëm me detyrën e përgjegjësit.



Stacioni i Konjatit

Komandim radio me pushtet

Proces-verbal i mbajtur në stacion

Nga auditimi konstatohet se:

1. **Titulli i gjetjes:** UKL Sh. A . nuk përdor sisteme inteligjente për menaxhimin e aktivitetit të saj me konkretisht në:

1.1 Komunikimin, sinjalizimin, matjen e niveleve dhe shpërndarjes së ujit, siç janë matja e presioneve, matja e prurjeve dhe niveleve të ujit në depo.

1.2. Hartimin e bilancit total dhe pjesorë të prodhimit shpërndarjes dhe me qëllim minimizimin e humbjeve të ujit në rrjet.

Situata: Llogaritja e sasisë së ujit të shpërndarë kryhet me afërsi duke llogaritur fuqinë e pompave. Në komunikimin e puseve, stacioneve të pompimit, depove përdoret mjete celular. UKL Sh. A . ka lënë jashtë vëmendjes investimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit, mungon informatizimi si në stacionet e pompimit dhe në depot e ujit.

Ndikimi/efekti:

- Duke pasur mungesë të pajisjeve teknologjike për matjen e ujit mund të çojë në një mos koordinim në kohë të punonjësve dhe si për pasojë mund të shkaktohen dëme në sistemin e shpërndarjes.
- Rritje të normës së humbjeve teknike dhe administrative të ujit, probleme të vazhdueshme me mirëmbajtjen e rrjetit të distribuimit të ujit.

Shkak: Mungesa e strategjisë IT në investime.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: UKL Sh. A . për arritur objektivat e saj duhet të hartoj një plan strategjik IT për kryerjen e investimeve sisteme TI inteligjente për matjen e presioneve, prurjeve, nivelin e ujit në depo etj me objektiv krijimin e një strukture dispeçerie për menaxhimin e prodhimit, trajtimit, transportimit dhe shpërndarjes të ujit të pijshëm në sistem 24 orë/7.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

2. Titulli i gjetjes: UKL Sh. A . nuk përdorë Teknologjinë e Informacionit në trajtimin e ujit (Pompat e shpërndarjes së klorit janë jashtë funksionit)

Situata: Klorifikimi ujit në qytetin e Lushnjes kryhet manualisht nga punonjësit e ujësjetllës

Ndikimi/efekti: cilësi e ujit e pa monitoruar në kohe reale.

Shkaku: Mungesë e investimeve TI inteligjente

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: UKL Sh. A . duhet ti kushtojë vëmendje kryerjen e investimeve TI inteligjente në analizimin dhe trajtimin e ujit.



Depo uji



Pompat e Klorit



Saraçineskë depo

3.

Titulli i gjetjes: Ambientet e pompave, puseve dhe depove janë të rrethuara dhe të ruajtura me roje private por për të rritur sigurinë është e nevojshme përdorimi i sistemeve inteligjente survejimi.

Situata: Në ambientet e pompave dhe depove të UKL Sh. A .mungojnë sisteme inteligjente survejimi.

Ndikimi/efekti: Siguri e ulët e aseteve.

Shkaku: Mungesë planifikimi dhe Investimi

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të kryejnë vlerësimin e sigurisë në sistemin e prodhimit, të shpërndarjes së ujit dhe duke vlerësuar kohën dhe mundësitë financiare të hartojnë plane investimi për rritjen e sigurisë nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së Informacionit.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.8, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës me komentet dhe shënimet pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.9. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet



Objektivi i auditimit: Parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ambienti fizik i dhomave të serverëve.

Dhoma e serverave është vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit, sinjalizimit dhe pajisje të tjera elektronike. Dhoma e serverave është pika më sensibil e një sistemi informatikë dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Ambientet e dhomës së serverave të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.



- *Fotografia 1 dhe 2: Paraqesin dy Rack-e me struktura fizike metalike dhe pjesët përbërëse të sistemit të pajisjeve elektronike dhe elektrike: server, switch, router, UPS, panele etj*
- *Fotografia 3: Paraqet sistemin e ftohjes së dhomës së serverave.*

Nga Auditimi u konstatua se:

1. Titulli i gjetjes Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën më të mirë si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

a. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të



njëjtën hapësire sipër tavanit ose nën dysheme

b.Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

c.Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

2.Titulli i gjetjes Mungon Siguria e Hyrjes në dhomë. Duhet të jetë e siguar me anë të një sistemi elektronik dhe natyrisht duhet të ketë dhe sistem alarmi në rast thyerje.

Situata: Ambiente të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në udhëzimet e AKSHI-t.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marr masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Testimi i Web të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A. për dobësi .

Për testimin e performancës së faqes së internetit të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. <http://www.ukl.al> u krye një testim i sigurisë dhe mangësive.

3. Titulli i gjetjes Faqja e Web të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., nuk është e populluar me materialet dhe informacionet e nevojshme. Duke mos kryer funksionin e saj.

4. Titulli i gjetjes Komunikimi ndërmjet Web Browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, i cili i merr dhe jep informacion në mënyrë jo të sigurt në rrjet. Kjo sjell që, një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjetin, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesoret nga rrjeti, duke përfshirë (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive).

Nëse ndodh një sulm, tipit të software-ve dhe versioni i përdorur identifikohen lehtësisht dhe mund të përdoren për sulme specifike.

Mbrojtësi X-XSS i HTTP dikton shfletuesin (browserin) të mos hap faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar. Për shkak të këtij mbrojtësi, web siti ekspozohen përdoruesit tek sulmuesit e XSS, nëse faqja web i ka këto dobësi.

Situata: Komunikim pa norma sigurie.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Ndikimi/efekti: Humbje informacioni, prishje të imazhit.

Shkaku: Mos përdorim të rekomandimeve për sigurinë e faqeve web.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marri masat për të rikonfiguruar Web Server të përdor protokollin HTTPS, i cili kodon komunikimin ndërmjet Web Browserit dhe Serverit

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.9, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.10. Të ndryshme

Menaxhimi i asetëve nga UKL Sh. A. nëpërmjet programit Web Gis

Verifikimi i përdorimit të Aplikacionit Web Gis me qëllim që të dhënat të regjistrohen , programi të popullohet në mënyrë që të gjitha asetet e Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. të ruhen në një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale, për të rritur efektivitetin dhe eficientësinë.

Për menaxhimin e asetëve në UKL Sh. A . është implementuar Programi “Web-GIS, i cili është një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale ndërtuar mbi arkitekturën multrole dhe multuser.

Në këtë sistem regjistrohen:

| | | |
|--------------------|------------------------|-----------------------|
| 1. Ankesat | 11. Burim vetërrjedhje | 21. Kanalizim i Hapur |
| 2. Zonë faturimi | 12. Pus | 22. Pusetë-Kanalizime |
| 3. Pus familjar | 13. Stacion pompimi | 23. Gradele |
| 4. Lidhje uji | 14. Depo Uji | 24. Pikë derdhje |
| 5. Klient | 15. Impiant Pastrimi | 25. Impiant trajtim |
| 6. Bashkues | 16. Nyje | 26. Stacion pompimi- |
| 7. Linjë | 17. Zonë hidraulike | 27. Ndërtese |
| 8. Pusetë | 18. Bashkues mbi linjë | 28. Rrugë |
| 9. Hidrant | 19. Ndaj linjë | |
| 10. Ujëmatës zonal | 20. Kanalizim nën tokë | |



Sistemi ka të realizuar një sërë rolesh të cilat kanë mundësi krijimi apo aksesit të informacionit në aplikacion. Rolet(Grupet) janë si më poshtë:

- Administratori :

Ka mundësinë e menaxhimit të log-eve të sistemit. Sistemi mundëson monitorimin e çdo veprimi të kryer mbi të, në formën e log-eve. Loge-t mund të aksesohen dhe prej tyre të nxirren monitorime të ndryshme, duke filtruar sipas përdoruesit, datës dhe veprimet mbi sistemin.

- Punonjësi i Ujësjetllës (ujë_punonjës)

Punonjësi i Ujësjetllës ka të drejtë të shtojë dhe të ndryshojë të gjitha objektet që kanë lidhje me rrjetin e ujësjetllës. Të gjitha të dhënat e hedhur prej tij nuk mund të ndryshohen nga asnjë përdorues tjetër përveç administratorit të sistemit të shoqëruar me një urdhër ose dakordësi të përdoruesit që ka hedhur të dhënat. Ky përdorues ka gjithashtu të drejtë të lexojë por jo të modifikojë të gjithë objektet që hidhen dhe mirëmbahen nga sektori i kanalizimeve.

- Vizitori i Ujësjetllës

Vizitori i Ujësjetllës ka të drejta leximi mbi të gjitha objektet e rrjetit të ujësjetllës. Ai në çdo rast mund të verifikojë, analizojë, filtrojë, eksportojë të dhëna që kanë lidhje vetëm me rrjetin e ujësjetllës.

- Punonjësi i Kanalizimeve

Punonjësi i Kanalizimeve ka të drejtë të shtojë dhe të ndryshojë të gjitha objektet që kanë lidhje me rrjetin e kanalizimeve. Të gjitha të dhënat e hedhur prej tij nuk mund të ndryshohen nga asnjë përdorues tjetër përveç administratorit të sistemit të shoqëruar me një urdhër ose të modifikojë të gjithë objektet që hidhen dhe mirëmbahen nga përdorueset e rrjetit të ujësjetllës.

- Vizitor

Vizitor është një përdorues i sistemit i cili ka të drejtë të lexojë çdo informacion që hidhet si për rrjetin e ujësjetllës ashtu dhe atë të kanalizimeve. Ai nuk ka të drejtë hedhje apo ndryshimi të dhënash në asnjë nga objektet e sistemit.

Për UKL Sh. A. një menaxhim i mirë i Web Gis do sjellë rritjen e nivelit shërbimit për komunitetin përmes krijimit, përvetësimit, operimit, mirëmbajtjes së aseteve të Sh. A.

Me përdorimin e Web Gis UKL Sh. A. mund të përcaktojë vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të zarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin(vendin) e objektit.

Nga Auditimi u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

1. Titulli i gjetjes: Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve (WebGis) i implementuar në UKL Sh.A. është populluar në një përqindje të ulët duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të gjithë pjesët përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKL Sh. A. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar.

Situata: Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve Web-Gis në UKL Sh. A. është ndërtuar mbi një arkitekturën multrole dhe multuser. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të zarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin(vendin) e objektit. Nuk mund të gjenerojë raporte të plota për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxherët, punonjësit e ujësjellësit, ashtu dhe për vizitorët (qytetarët).

UKL Sh. A. nuk ka përfunduar regjistrimin e aseteve në programin Web Gis. Ky sistem nuk përcakton vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi.

Ndikimi/efekti: Mos përdorim dhe menaxhim me eficient, ekonomikiteti dhe efektivitet të aseteve të UKL Sh. A.

Shkaku: Mungesa në menaxhim nga Staf i lartë Drejtues në implementim dhe shfrytëzim të Web-Gis në UKL Sh. A.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKL Sh. A. të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në eficientë të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.10, datë 18.03.2019 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 8/12, datë 25.03.2019. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.



VII. DISA KONSTATIME DHE REKOMANDIME

A. OPINION I AUDITIMIT:

Grupi i auditimit KLSH duke vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit në përmbushjen e misionit të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., duke mbështetur auditimin në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 1 Neni 22, Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Neni 3 dhe 14, Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA), COBIT 4.1, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23, ISSAI 100.36,48, ISSAI 5310), pas shqyrtimit të të dhënave dhe dokumentacionit TI të vënë në dispozicion nga Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., arriti në konkluzionin se:

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore.

Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe rekomandimet e AKSHIT.

Sistemet TI janë të kompromentuara nga mungesa e Strategjisë TI, dhe mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të limituara financiare që ka UKL Sh. A. për mbështetje e veprimtarisë së saj.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi UKL Sh. A nuk ka rregullore për strukturën IT, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e back up, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.1, faqet nr.8-10. Të Raportit të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve t, dokumentacion mbi procedurat e back up etj.)..

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nuk ka një analizë të nevojave për trajnim të stafit IT.

Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit.

Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.



Më hollësisht trajtuar në pikën VI.1, faqen nr. 10. të Raportit të Auditimit.

2.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe IT të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.1, faqet nr. 10-11 të Raportit të Auditimit.

3.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A në hartimin e strategjisë së Teknologjinë e Informacionit të parashikojnë strategji zhvillimi të burimeve njerëzore IT në UKL Sh. A si një strukture të pa varur, pranë vendimmarrjes, të plotësuar me personel në vartësi të detyrave të ngarkuara në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e AKSHIT.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.2, faqet nr. 11-12. të Raportit të Auditimit.

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Standardet e Praktikave më të mira rekomandojnë që Qeverisja TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit dhe mund t'i referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikat duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT.



Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka vendosur politika e parime mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve dhe politikave të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.2, faqen nr. 12 të Raportit të Auditimit.

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., të marrin masa për familjarizimin me rregulloret dhe politikat TIK për të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

6.1 Gjetje nga Auditimi Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

6.2 Gjetje nga Auditimi Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.2, faqet nr. 13-14 të Raportit të Auditimit.

6.3 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A në bashkëpunim me specialistin e IT të marrin masa për:

- Monitorimin e risqeve në infrastrukturën IT nëpërmjet identifikimit, prioritarizimit hartimit të një plan veprimi për minimizimin e tyre.
- Dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve në infrastrukturën IT.
- Menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi



7. Gjetje nga Auditimi Strukturat e IT-së nuk janë përfshirë në procesin e identifikimit të nevojave si dhe nuk përfshihen në procesin e menaxhimit të tyre

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3., faqet nr. 14-15 të Raportit të Auditimit.

7.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e strukturës IT, e cila (krahas kryerjes së detyrave funksionale) do të kryejë analizimin, prioritarizimin dhe planifikimin e nevojave për sistemet e reja dhe ekzistuese të Teknologjisë së Informacionit..

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi Kontratat MNSH të lidhura nga UKL. Sh. A me OE “Z” sh.p.k., OE “A” sh.p.k dhe OE “Y” sh.p.k, për mirëmbajtjen e sistemeve respektivisht janë hartuar në mos përputhje me pikën nr.6 të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” (Kontrata e MNSH nuk është aneks më vete dhe nuk përmban përcaktimet e udhëzimit të mësipërm për matjen e nivelit të shërbimit)

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4., faqet nr. 15-16. të Raportit të Auditimit.

8.1. Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të hartojë e zbatojë në të ardhmen Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) respektivisht kontratën nr. 3 me fitues operatorin ekonomik “Z” sh.p.k., kontratën nr.5 me fitues operatorin ekonomik “A” sh.p.k. dhe kontratën nr. 640/6 me fituese Operatorin Ekonomik “Y” sh.p.k, ka një mangësi në procesin e vlerësimit të shërbimit (*Kolaudimin*) kur dihet që përfundimi i implementimit të çdo projekti shoqërohet me kolaudime të pjesshme ose me një **analizë kosto-përfitim (matja e cilësisë së shërbimit)** me përgjegjës z. për kontratën nr.3 dhe 5 si dhe z. për kontratën nr. 640/6 sipas udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike” **pjesa III pika 10 Aneksi 2** dhe sipas **pikës 8 (ç)** të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4., faqen nr. 16 të Raportit të Auditimit.

9.1. Rekomandimi Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa përkatëse për ngritjen e një strukture të posaçme që të bëjë të mundshme shoqërimin me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.



Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A. në kontratat nr.5 me OE “A sh.p.k. dhe nr.640/6 me OE “Y” sh.p.k, nuk ka zbatuar rregullat dhe procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimit sipas *Udhëzimit nr. 2*, datë 02.09.2013 “*Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike*” **pjesa III pika 10 Aneksi 2** dhe sipas **pikës 8 (dh)** të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për Hartimin e MNSH*”

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4., faqet nr. 16-17 të Raportit të Auditimit

10.1 Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa ligjore për caktimin e personave përgjegjës dhe informacionin e kontaktimit të tyre për zbatimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve duke dokumentuar procesin monitorues.

Brenda vitit 2019 Në vijimësi

11: Gjetje nga Auditimi Nga auditimi i Kontratës **nr.5** me fitues Operatorin Ekonomik “A sh.p.k. me Administrator z. dhe **nr.640/6** me fituese Operatorin Ekonomik “Y” sh.p.k me administrator z. , u konstatua se nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi.* Përgjegjës për hartimin dhe firmosjen e këtyre kontratave janë respektivisht për kontratën nr.5 z. administrator i subjektit dhe për Kontratën nr.640/6 z. administrator i subjektit.

Kjo në kundërshtim me **pikën 7** të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për “*Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit*”.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4., faqe nr.17. të Raportit të Auditimit

11.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit të marrë masat përkatëse për përfshirjen në kontrata të kohës së raportimit, kohës së përgjigjes, prioritetit dhe përshkallëzimeve në seksionin e të drejtave dhe detyrimeve në mënyrë që të zgjidhen kërkesat dhe të shmangen incidentet e mundshme që të zbatohë Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Brenda vitit 2019 Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.

12.1. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. kryen back-up të bazës së të dhënave po në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (dhoma e serverëve).



Më hollësisht trajtuar në pikën VI.5., faqet nr.17-18. të Raportit të Auditimit

12.2. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. në bashkëpunim me Specialistin e IT të marrin masa për miratimin e një plani për emergjenca dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit.

Gjate vitit 2019 në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve , aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKL Sh. A .

13.1. Gjetje nga Auditimi: Siguria e infrastrukturës network në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, paisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.
- b. Server të dedikuar per CA (Certificate Authority)
- c. Server i dedikuar për mail server (Exchange server)
- d. Firewall Hardware
- e. Switch të menaxhueshëm

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.5, faqet nr. 18-19. të Raportit të Auditimit.

13.2 Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marrin masat për t’u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.; server të dedikuar për CA; Server i dedikuar për mail server, Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm.

Gjatë vitit 2020 dhe në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Hapja dhe ndalimi i aksesit të informacionit për personat e punësuar apo pushuar ose të transferuar nga puna monitorohet dhe nuk shoqërohet me një procesverbal për të vërtetuar që aksesit i informacionit është ndaluar në kohën e duhur për të shmangur humbjen ose keqpërdorimin e informacionit. Krijimi dhe fshirja e userave (përdoruesve) bëhet verbalisht nga administruesit e programeve përkatës.

14.1 Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A . nuk ka procedura për të përcaktuar akseset dhe privilegjet e përdoruesve në mënyrë që përdorimi i informacionit të jetë në përshtatje me nivelin dhe pozicionin e punës, duke qenë se programet janë ndërtuar mbi arkitekturën multirole dhe multiuser duke pasur mundësi krijimi apo aksesit të informacionit në aplikacion.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.6, faqen nr. 20-21. të Raportit të Auditimit.



14.2 Rekomandimi: UKL Sh. A . duhet të hartojë rregulla dhe procedura për krijimin dhe fshirjen e përdoruesve për personat e punësuar dhe ata të larguar ose transferuar, ndarjen e duhur të roleve në program për aksesin në informacion.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Nuk kryhen ndryshime sistematike të fjalëkalimeve (minimalisht 60 ditë) , e përcaktuar dhe në manualin e përdorimit të programit Al-Billing , në mënyrë që ruajtja e të dhënave të jetë më e sigurt duke ulur mundësinë e hyrjeve të paautorizuara në të dhënat e sistemit

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.6, faqen nr. 21. të Raportit të Auditimit.

15.1 Rekomandimi: UKL Sh. A . duhet të ndjekë procedura për përdoruesit e programeve në mënyrë që ndryshimi i fjalëkalimeve të kryhet sistematikisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi Referuar ligjit nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” i ndryshuar, deklarata e Konfidencialitetit për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e informacionit sensitiv nuk përkon me datën e fillimit të punës së punonjësve që kanë akses në të dhënat e sistemit.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.6, faqet nr.21-22 të Raportit të Auditimit.

16.1 Rekomandimi: Punonjësit e UKL Sh. A . duhet të firmosin deklaratat e konfidencialitetit në kohën që kanë akses në të dhënat e programeve që disponojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga Auditimi: UKL SH.A nuk ka kryer (për periudhën nën auditim 1.01.2018-31.12.2018) procedurat për miratimin e faturës tatimore duke lejuar gjenerimin nga sistemi “X” të faturave me TVSH pa kod fiskal

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqet nr.22-25 të Raportit të Auditimit.

17.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për miratimin e faturës tatimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A .përdor Sistemin e Faturimit “X”

a. Të pa regjistruar si aset

b. Pa suport (kontrata nr. 640/6 prot. datë 27.06.2018 ndërmjet UKL Sh. A .dhe OE “Y”, për periudhën 27.06.2018 – 26.06.2022 nuk ka përfshirë mirëmbajtjen e Sistemin e Faturimit “X”)



Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqe nr.25 të Raportit të Auditimit.

18.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A të marrin masa për zbatimin e Sistemin e Faturimit “X” si dhe zbatimin të procedurave ligjore për sigurimin e suportit të mirëmbajtjes nëpërmjet marrëveshjes së nivel shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga Auditimi: Në Sistemin e Faturimit “X” janë kryer veprime për sistemime duke gjeneruar 458403 dublikata në fushën ID për të cilat nuk mbahet dokumentacion për argumentimin e tyre.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqet nr.25-29 të Raportit të Auditimit.

19.1 Rekomandimi: : Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për dokumentimin e çdo procesi pune që sjell ndryshime në bazat e të dhënave të sistemeve TI.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga Auditimi: Në Sistemin e Faturimit “X” janë kryer veprime për sistemime nga përdoruesit “import” dhe “ora IMPORT” që nuk figurojnë në listën e përdoruesve por kanë gjeneruar respektivisht 8 dhe 4838 veprime me pasojë krijim dublikata.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqen nr.29 të Raportit të Auditimit.

20.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A të gjejë përgjegjësit për dy përdoruesit e mësipërm.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “X” për periudhën 01 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 12247 “Hendeqe” në fushën ID.(bashkëlidhur këtij akt konstatimi rekordet me hendeqe në fushën ID).

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqet nr.29-30 të Raportit të Auditimit.

21.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A të analizojnë situatën dhe të marrin masa për të mos lejuar kryerjen e sistemimeve në bazat e të dhënave nëpërmjet fshirjes së rekordeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A .nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operacionale në Sistemin e Faturimit “X” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “X” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKL Sh. A .

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqen nr.30 të Raportit të Auditimit.



22.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Sistemit të Faturimit “X” dhe përditësimin e këtij manuali.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A nuk ka të drejta mbi kodin në burim në Sistemin e Faturimit “X” kompania “shpk” është pronare dhe administratore e këtij sistemi (përdoruesi është user me të drejta të plota).

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.7, faqet nr.30-31 të Raportit të Auditimit.

23.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. të ketë një punonjës si administrator të sistemit dhe të ketë të drejta të plota mbi kodin në burim të Sistemit të Faturimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A . nuk përdor sisteme inteligjente për menaxhimin e aktivitetit të saj me konkretisht në:

1.1 Komunikimin, sinjalizimin, matjen e niveleve dhe shpërndarjes së ujit, siç janë matja e presioneve, matja e prurjeve dhe niveleve të ujit në depo.

1.2 Hartimin e bilancit total dhe pjesorë të prodhimit shpërndarjes dhe me qëllim minimizimin e humbjeve të ujit në rrjet.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.8, faqet nr.31-32 të Raportit të Auditimit.

24.1 Rekomandimi: UKL Sh. A . për arritur objektivat e saj duhet të hartoj një plan strategjik IT për kryerjen e investimeve sisteme TI inteligjente për matjen e presioneve, prurjeve, nivelin e ujit në depo etj me objektiv krijimin e një strukture dispeçerie për menaxhimin e prodhimit, trajtimit, transportimit dhe shpërndarjes të ujit të pijshëm në sistem 24 orë/7

Gjatë vitit 2020 dhe në vijimësi

25. Gjetje nga Auditimi: UKL Sh. A . nuk përdorë Teknologjinë e Informacionit në trajtimin e ujit (Pompat e shpërndarjes së klorit janë jashtë funksionit)

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.8, faqet nr.32-33 të Raportit të Auditimit.

25.1 Rekomandimi: UKL Sh. A . duhet ti kushtojë vëmendje kryerjen e investimeve TI inteligjente në analizimin dhe trajtimin e ujit..

Gjatë vitit 2020 dhe në vijimësi

26. Gjetje nga Auditimi: Ambientet e pompave, puseve dhe depove janë të rrethuara dhe të ruajtura me roje private por për të rritur sigurinë është e nevojshme përdorimi i sistemeve inteligjente survejimi

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.8, faqen nr.33 të Raportit të Auditimit.



26.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. të kryejnë vlerësimin e sigurisë në sistemin e prodhimit, të shpërndarjes së ujit dhe duke vlerësuar kohën dhe mundësitë financiare të hartojnë plane investimi për rritjen e sigurisë nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së Informacionit.

Gjatë vitit 2020 dhe në vijimësi

27. Gjetje nga Auditimi: Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d.Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

e.Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës

27.1 Gjetje nga Auditimi: Mungon Siguria e Hyrjes në dhomë. Duhet të jetë e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe natyrisht duhet të ketë dhe sistem alarmi në rast thyerje.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.9, faqet nr.33-35 të Raportit të Auditimit.

27.2 Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marr masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2020 dhe në vijimësi

28. Gjetje nga Auditimi: Faqja e Web të Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A., nuk është e populluar me materialet dhe informacionet e nevojshme. Duke mos kryer funksionin e saj

28.1. Gjetje nga Auditimi: Komunikimi ndërmjet Web Browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, i cili i merr dhe jep informacion në mënyrë jo të sigurt në rrjet. Kjo sjell që, një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjetin, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesoret nga rrjeti, duke përfshirë (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive).

Nëse ndodh një sulm, tipit të software-ve dhe versioni i përdorur identifikohen lehtësisht dhe mund të përdoren për sulme specifike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Mbrojtësi X-XSS i HTTP dikton shfletuesin (browserin) të mos hap faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar. Për shkak të këtij mbrojtësi, web siti ekspozohen përdoruesit tek sulmuesit e XSS, nëse faqia web i ka këto dobësi.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.9, faqet nr.35-36 të Raportit të Auditimit.

28.2 Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. A. të marri masat për të rikonfiguruar Web Server të përdor protokollin HTTPS, i cili kodon komunikimin ndërmjet Web Browserit dhe Serverit.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

29. Gjetje nga Auditimi: Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve (WebGis) i implementuar në UKL Sh. A. është populluar në një përqindje të ulët duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të gjithë pjesët përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKL Sh. A. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.10, faqen nr.36-38 të Raportit të Auditimit.

29.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKL Sh. A. të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në efencë të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i ë aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit.

Menjëherë dhe në vijimësi

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e këtij Raporti auditimi është dhe dokumentacioni i mbajtur, si më poshtë:

AKT-KONSTATIME

1. Akt konstatimi nr. 1, datë 18.03.2019
2. Akt konstatimi nr. 2, datë 18.03.2019
3. Akt konstatimi nr. 3, datë 18.03.2019
4. Akt konstatimi nr. 4, datë 18.03.2019
5. Akt konstatimi nr. 5, datë 18.03.2019
6. Akt konstatimi nr. 6, datë 18.03.2019
7. Akt konstatimi nr. 7, datë 18.03.2019
8. Akt konstatimi nr. 8, datë 18.03.2019
9. Akt konstatimi nr. 9, datë 18.03.2019
10. Akt konstatimi nr. 10, datë 18.03.2019

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A.”

Tabela e Shkurtimeve

| Nr. | Shkurtimi | Emërtimi i Plotë |
|------------|------------------|--|
| 1 | UKL | Ujësjetllës Kanalizime Lushnje |
| 1 | BCP | Business Continuity Plan |
| 2 | BCC | <u>Business Continuity Center</u> |
| 3 | DR | Disaster Recovery |
| 4 | DRC | Disaster Recovery Center |
| 5 | KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| 6 | MNSH | Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit |
| 7 | NID | Numri i Identifikimit |
| 8 | OE | Operator Ekonomik |
| 9 | TI(IT) | Teknologjia e Informacionit |
| 10 | TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi |
| 11 | VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| 12 | SHI | Shoqëria e Informacionit |
| 13 | UPS | <u>Uninterruptible Power Supply</u> |
| 14 | USB | Universal Serial Bus |
| 15 | GG | Government Gateway |
| 16 | EDRMS | Electronic Document and Record Management System |
| 17 | PKI | Public Key Infrastructure |
| 18 | IP | Internet Protocol |
| 19 | VPN | Virtual Private Network |
| 20 | KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |